



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1301/1 Prot.

Tiranë, më 25/11/2016

VENDIM

Nr. 87, datë 25/11/2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1301 Prot., datë 18.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkisë Belsh me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr. 352/16 Prot, datë 28.10.2016 ka kërkuar nga Bashkia Belsh t'i vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:

1. Kontrata e pastrimit aktualisht në zbatim.
2. Rezultati, renditja e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit që kanë prodhuar këto kontrata, së bashku me informacionin për skualifikimin e mundshëm dhe ankimet e operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Me shkresën nr. 2733/1 Prot., datë 02.11.2016 Bashkia Belsh i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke u shprehur se "...Të gjithë informacionin e kërkuar e keni të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), në buletinet përkatëse".

Pas refuzimit të dhënies së informacionit, ankuesi Qendra "Res Publica" kërkon nga KDIMP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", neni 14, pika 2 parashikon:

2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit: a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Gjithashtu, neni 16, pika 2 e ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", parashikon:

2. Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni . Kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkesës, duke i treguar kërkuesit adresën e saktë të faqes ku mund të gjendet në formë elektronike.

Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7, pika ë) të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik privat.

Për sa më sipër, informacioni në lidhje me kontratën e pastrimit, rezultatin, renditjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit që kanë prodhuar këto kontrata, së bashku me informacionin për skualifikimin e mundshëm dhe ankimet e operatorëve pjesëmarrës në procedurë, është informacion publik. Në të njëjtën kohë, dhënia e tyre duhet të trajtohet në raport edhe me nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (nëse dokumentacioni i kërkuar i nënshtrohet tërësisht apo pjesërisht kufizimeve të parashikuara në këtë nen).

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Belsh, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

#### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 1301 Prot., datë 18.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Belsh, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Bashkia Belsh, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (shkresa nr. 352/16 Prot, datë 28.10.2016), brenda datës 07.12.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 25.11.2016.

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**